



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.62/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore, ndaj M. G., Prokuror në Prokurorinë Themelore në P. - Departamenti i Përgjithshëm, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit KPK/Nr.1260/2024, të datës 25 nëntor 2024, në seancën të kolegjit të mbajtur më datë 29.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. G. - Prokuror në Prokurorinë Themelore në P. - Departamenti i Përgjithshëm, ndërsa vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së), KPK/Nr.1260/2024, i datës 25 nëntor 2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë, (në tekstin në vazhdim Këshilli), me vendimin KPK/Nr.1260/2024, të datës 25 nëntor 2024, ka vendosur: I. Aprovohet si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr.9/2024, i datës 05 nëntor 2024, në rastin disiplinor ndaj Prokurorit M. G., Prokuroria Themelore në P. - Departamenti i Përgjithshëm. II. Vërtetohet se te Prokurori M. G., janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2, nënparagrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror. III. Prokurorit M. G., i shqiptohet sanksioni disiplinor “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë përqind (30%) për një periudhë kohore gjashtë (6) muaj”, në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L -057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi prokurori M. G., në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin e goditur për shkak të shkeljeve procedurale të përcaktuara me Rregulloren

nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, si dhe Ligjit nr.06/L0057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, ankesën e subjektit hetimor (Prokurorit të shtetit M. G.), ta aprovojë si të bazuar dhe vendimin e Këshillit, KPK/Nr.1260/2024, të datës 25.11.2024, ta anulojë, duke e liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Me përgjigje në ankesë Këshilli, ka propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, ta refuzoj ankesën dhe ta vërtetojë vendimin e Këshillit KPK/Nr.1260/2024, të datës 25.11.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli, më datë 30 shtator 2024, nga Autoriteti Kompetent, P. K. U.D. Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në P., te Këshilli, ka paraqitur kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Prokurorit M. G., Prokuroria Themelore në P. - Departamenti i Përgjithshëm. Më datë 09 shtator 2024, Autoriteti Kompetent i PTH – P., përmes e-mailit zyrtar, ka pranuar njoftimin nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës se, më datë 23 korrik 2024, kjo e fundit ka mbyllur pjesërisht rastin PPN.nr.45/2024, sa i përket pretendimeve për përfshirjen e prokurorëve: A. Sh., R. K., M. G., E. G., B. S. dhe Sh. B., në vepra penale të korrupsionit të paraqitura në propozimin për delegim të lëndës në kompetencë të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.1.nr.24/23, të datës 12 mars 2024, për shkak se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Dyshimet e para kanë qenë se në çështjen penale në trajtim ndaj të pandehurit Sh. P., në lëndën e evidentuar me shenjën PP/I.nr.24/2023, për shkak të veprës penale nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së, gjatë fazës hetimore është bërë ekzaminimi i dëshmisë A22 - telefoni i markës "...", në pronësi të të pandehurit Sh. P., nga ku kanë rrjedhë komunikime për dyshime në implikim edhe të prokurorëve në fjalë. Për rastin në fjalë është njoftuar edhe Kryesuesi i Këshillit. Më datë 11.09.2024 U.D. Kryeprokurori ka kërkuar deklaratë lidhur me pretendimet në fjalë, ndër të tjera edhe për prokurorin M. G. . Më datë 10.09.2024, për rastin në fjalë lidhur me komunikimet e prokurorëve të apostrofuar, është kërkuar nga prokurori i cili e ka trajtuar rastin që të ofroj prova, përkatësisht transkriptet dhe të gjitha shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me dyshimet për sjellje eventuale të pahijshme për prokurorët e lartcekur. Më datë 26.09.2024 Autoriteti Kompetent, ka konstatuar si të pabazuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve të PTH – P.: R. K., A. Sh., Sh. B., E. G. dhe B. S., sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr.06/L – 057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ngase të njëjtit nuk janë përfshirë në asnjë komunikim me të pandehurin Sh. P. dhe nuk kanë vepruar për asnjë

moment në kundërshtim me Kodin e Etikës, apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit.

Sa i përket prokurorit M. G., Autoriteti Kompetent, ka gjetur se i njëjti ka pasur komunikime të drejtpërdrejta me të pandehurin Sh. P., një gjë e tillë është vërtetuar nga transkriptet e siguruara nga dosja në fjalë. Nuk është e qartë se çka saktësisht e lidhë prokurorin M. G. me personin Sh. P. .

Autoriteti Kompetent i ka rekomanduar Këshillit, që të hetohen veprimet e prokurorit M. G., dhe të njëjtit t'i shqiptohet sanksioni disiplinor “Vërejtje publike me shkrim” konform nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, për shkak të shkeljes së nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli, më datë 07 tetor 2024, me vendimin KPK/Nr.1025/2024, ka themeluar Panelin Hetimor, për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.9/2024, ndaj Prokurorit M. G. - Prokuroria Themelore në P. - Departamenti i Përgjithshëm.

Më datë 06 nëntor 2024, Këshilli, nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD.nr.9/2024, lidhur me lëndën PP.1.nr.24/23, të datës 12 mars 2024, në Prokurorinë Themelore në P. .

Në arsyetim të vendimit të atakuar, Këshilli ndër të tjera ka theksuar se: pas dëgjimit të Kryesueses së Panelit Hetimor, subjektit të hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesueses së Panelit dhe Prokurorit M. G., erdhi në përfundim se, në rastin AD.nr.9/2024, bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar shkelja disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi. Mesazhet mes Prokurorit M.G. dhe Sh. P. në datat 06.01.2023, 20.01.2023 dhe 31.03.2023, komunikon disa herë me shkrim pastaj edhe zhvillon biseda telefonike me zë, ku Sh. P. në komunikimin e datës 03.04.2023, i drejtohet prokurorit G. me fjalët “për atë që të thash, le njëherë mos u ngut”, prokurori i dërgon “Ok”. Më datë 01.06.2023 në rrjetin social Messenger fb, dhe pas bisedës me zë, komunikon me shkrim, ku P. e pyet: “a mos u takove mo me atë”, prokurori i përgjigjet “po” dhe P. vazhdon komunikimin “ajt dil si te mundesh rrimë”, ndërsa prokurori i përgjigjet “javën tjetër jam në S. ndalem, se sot jam i lodhen flm i nderuar”, këtë komunikim të prokurorit G., Sh. P., në. screen shoot ia dërgon personit me emrin A. Sh. në rrjetin social në ora 18:14 minuta (ku shihet edhe një foto e një arme (pushke) nga telefoni i E. M.) të cilit Sh. P. i kërkon t'i lajmërohet pasi i kanë hyrë një pune dhe ai nuk i kishte lajmëruar asgjë, të cilit në fakt ia dërgon komunikimin e lartcekur me prokurorin G.. Më datë 26.08.2023 dhe 27.08.2023, bisedojnë për t'u takuar në lokalit F. në Sh. –Sh. (dhe se personin L. nuk e njeh, mund të jetë pronari i lokalit). Në komunikimin e datës 06.01.2023, Prokurori G. i drejtohet P. me fjalët “ja ta kom ja ma ki ni trileqe”, ndërsa ai i'a kthen “ta kom”. Më datë 20.01.2023 dhe 27.07.2023 Prokurori G. i drejtohet me fjalët “desi bre Kosova Albana”, P. “Po desi druzhe”, ndërsa prokurori G. l'a kthen “sot e kom dërgu nesër e marr”. Më datë 24.08.2023 Prokurori G.

i drejtohet P. me fjalët “dje ishim për drekë me B. S. po nuk ishit hinem te kojshia qebaptore”, ndërsa ky i'a kthen “jo ishall” po të njëjtën datë P. i drejtohet G. me fjalët “Druzhe” ndërsa ky i'a kthen “respekt”.

Ka shtuar se në artikullin e “Betimi për Drejtësi”, “Telegrafi”, “Koha”, “Sinjali”, gjenden artikuj të postuar të cilët flasin për Sh. P., person i arrestuar për disa vepra penale dhe se i njëjti ka komunikuar me të dhe nga bisedat e zhvilluara vërehet se ka pasur raporte të ngushta miqësore. Përkundër faktit se Prokurori G.Sh. P. e njeh që 23 vite, i njëjti ka deklaruar se, nuk e ka ditur që ai ka qenë i dënuar, se i vetmi komunikim me të është për një inventar, mirëpo nëse i analizojmë komunikimet e tij, vërehet se Prokurori G.dhe Sh. P. në komunikimet e tyre askund nuk kanë përmendur inventarin. Në deklaratën e tij dorëzuar U.D. Kryeprokurorit dhe komunikimet e tij, pa asnjë mëdyshje vërtetohet fakti se ai është ftuar shumë herë për kafe nga Sh. P. dhe anasjelltas.

Ka shtuar se Paneli Hetimor, e ka vlerësuar se bashkëpunimi i Prokurorit G. gjatë procedurës disiplinore nuk ka qenë në nivelin e duhur, sepse deklarata e tij dhënë para Panelit, nuk ka qenë identike me mesazhet me të cilat ka komunikuar me telefonin e tij zyrtar me Sh. P., dhe ka pasur tendencë për mohimin e mesazheve. Nga ekstrakti i dënimeve penale dhe databaza e policisë, është vërtetuar se P. është recidivist i veprave penale, ka shumë raste në Policinë e Kosovës, ka qenë i dënuar, person me imazh jo të mirë dhe i arrestuar për vepër penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 i KPRK-së, gjersa vazhdon të mbetet në paraburgim për vepër penale të “Dhunimit”, nga neni 227 i KPRK-së, ku viktima dyshohet se është një i mitur, por Prokurori G. ka komunikuar me të dhe nga bisedat e zhvilluara vërehet se ka pasur raporte të ngushta miqësore, gjë të cilën e di tërë regjioni i P., dhe opinionin e gjerë, pasi që rastet e P. kanë qenë mediatike. Gjithashtu, prokurori M. G., ka pasur edhe raste të tjera disiplinore, në të cilat i është shqiptuar sanksioni disiplinor “Vërejtje publike me shkrim”, në bazë të Vendimit KPK/Nr.510/2022, të datës 14.04.2022, i cili vendim është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë është shpallur e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Ka shtuar se në seancën disiplinore të KPK-së, të datës 25.11.2024, prokurori M.K anëtar i KPK-së, nga Prokuroria Themelore në P., i cili ka punuar me prokurorin M. G. në po të njëjtën prokurori deklaroi se: “Qysh në vitin. 2016, kur i njëjti ishte dekretuar prokuror, ish Kryeprokurori i PTH – P., i kishte ftuar të gjithë në mbledhjen e parë të cilët i kishte udhëzuar që mos të hynë në këtë lokal (në lokalin e Sh. P.), e dini kush janë këta persona, as për kafe, as për ushqim, nuk kisha dashtë me ju pa në atë lokal, ndërsa prokurori M. G. kishte vazhduar ta frekuentonte këtë lokal. Bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe deklaratën e prokurorit M.K, anëtar i Këshillit, ka arritur të vërtetoj pa mëdyshje se veprimet e prokurorit M. G., bien ndesh me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2, nën par. 2.10 të Ligjit Nr.06/L-057 për

Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve “Shkel detyrat e tij zyrtare si prokuror”, dhe “Përfshihet në sjellje, qoftë kur janë në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorit të Shtetit, ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit”.

Këshilli, pas analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e Panelit Hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit dhe prokurorit M. G., me shumicë të votave erdhi në përfundim se, në rastin disiplinor AD.nr.9/2024, të vërtetuar me shkelje disiplinore, të njëjtit i shqiptohet sanksioni disiplinor “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë përqind (30%) për një periudhë kohore gjashtë (6) muaj”, në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Serioziteti i shkeljes disiplinore të kryer nga prokurori M. G., pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore, sjellja e përgjithshme e subjektit të hetimit, si dhe sjellja dhe bashkëpunimi në procedurë disiplinore dhe sanksionet e shqiptuara më parë për raste të tjera disiplinore, janë rrethana që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes shkeljes disiplinore dhe sanksionit disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe Kodit të Etikës Profesionale për Prokuror, drejt dhe në mënyrë plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të subjektit hetimor - prokurorit, se vendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i vendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Këshilli, ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për të konstatuar përgjegjësinë disiplinore të prokurorit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Këshilli, në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë përgjegjësia disiplinore e prokurorit nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i’ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e Këshillit, sepse në bazë të provave të administruara, Këshilli, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se prokurori M. G. është përfshire në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se komunikimi të cilin e ka bërë Prokurori M. G. me Sh. P. në datat 06.01.2023, 20.01.2023

dhe 31.03.2023, ku me të njëjtin ka komunikuar disa herë me shkrim pastaj edhe përmes bisedave telefonike me zë, ashtu siç janë përshkruar në arsyetimin e Këshillit, e të cilat kjo gjykatë nuk e pa të nevojshme ti elaboroj sërish, vërtetohet fakti se Prokurori M. G. ka bërë shkelje disiplinore të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe Kodit të Etikës Profesionale për Prokuror.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e Këshillit, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “ 1. Prokurori kryen shkelje disiplinore nëse ai ose ajo: 1.3. shkel detyrat e tij zyrtare si prokuror”. 2. Shkelje e detyrave të prokurorit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: 2.10. përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit”.

Me nenin 7 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “ Masa disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performancën dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore ”.

Me nenin 3 pika c) dhe f) të Kodit të Etikës Profesionale për Prokuror, përcaktohet se: “c). Prokurori përjashton çdo sjellje që mund të ngjallë dyshime lidhur me paanshmërinë e motiveve të tij dhe nuk përfshihet në sjellje që dëmtojnë nderin dhe dinjitetin e Prokurorit të Shtetit, si dhe mund të dëmtojnë besimin e publikut, f). Prokurori duhet të shmangë çdo kontakt dhe aktivitet privat ose biznesor, i cili mund të ngjallë dyshime për punën e tij në Prokurorinë e Shtetit. Kjo vlen gjatë ushtrimit të detyrës dhe në jetën private”.

Me nenin 5 pika d) dhe h) të Kodit të Etikës Profesionale për Prokuror, përcaktohet se: “ Prokurori duhet të bëjë sjellje të ndershme dhe profesionale në punën zyrtare dhe jetën private bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale, h). Prokurori duhet të veprojë me respekt kur nder vepron me të tjerët, si në marrëdhëniet e

tyre me qytetarët dhe palët e jashtme, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me kolegët, duke përfshirë edhe eprorët dhe vartësit”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe dispozitave të Kodit të Etikës Profesionale për Prokuror, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se Këshilli, drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e prokurorit të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i’ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Gjykata Supreme, vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga Këshilli, është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marr parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga prokurori, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, performanca dhe sjellja e përgjithshme e prokurorit si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i prokurorit në procedurë disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar gjetjen e nivelit të proporcionalitetit, në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në raport me pretendimet e prokurorit se pretendimet lidhur me dyshimet për veprat penale nga Sh. P. nga neni 267, 366, 227 të KPRK-së, kanë ndodhur pas komunikimit me të, ky pretendim është irelevant për vendosje ndryshe në këtë çështje, kjo për faktin se personi në fjalë me të cilin prokurori ka komunikuar me të, përveç këtyre veprave për të cilat dyshohet, i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra të tjera penale dhe kjo vërtetohet nga shkresat e lëndës të bashkangjitura nga subjekti hetues, prandaj një pretendim i tillë është në tërësi i pa bazuar dhe nuk e largon nga përgjegjësia disiplinore prokurorin në fjalë.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr.62/2024, me datë 29.01.2025.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v